



MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJEVE

Formatted: Centered

Formatted: Normal, Tab stops: 3,52 cm, Left

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

Raportimi tek GIZ-SARED / AAM Aktivitetet e Grupeve të Zinxhirit të Vlerës datë 13 - 14 Prill 2017:

Rritja e të ardhurave për prodhuesit dhe grumbulluesit e Bimëve Aromatike dhe Medicinale (BAM) në Shkodër (2 grupe, në Tamarë dhe Shkrel)

OJF Zbatuese: Shoqata Shqiptare e Marketingut (ShShM)

Region and date	VC	NGO / association	Initiative /Component	No. of VC-around	location	name of facilitator / expert	name of liaison - extension officer(s)
Shkodër 13 Prill 2017	MAP	AAM c: Besart Pudja p: +355 66 55 39 269 e: a.pudja@aam.al c: Keti Luli p: +355 69 22 68 879 e: info@aam.al	Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Vrithit lidhur me: "Kërkimi marketing dhe mjetet e nevojshme për hulumtimin e tregut".	1	Vrith / Shkrel, Shkoder	Besard Pudja / Iris Kazazi	DoA, Shkoder – Xheladin Zekaj
Shkodër 14 Prill 2017	MAP	AAM c: Besart Pudja p: +355 66 55 39 269 e: a.pudja@aam.al c: Keti Luli p: +355 69 22 68 879 e: info@aam.al	Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Tamarës lidhur me: "Kërkimi marketing dhe mjetet e nevojshme për hulumtimin e tregut".	1	Tamara Shkoder	Besard Pudja / Iris Kazazi	DoA, Shkoder – Xheladin Zekaj

13 Prill 2017 – Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Vrithit lidhur me: "Kërkimi marketing dhe mjetet e nevojshme për hulumtimin e tregut".

Ekspert: PhD kandidate Iris Kazazi, Ekstensionist pranë Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër: z. Xheladin Zekaj, datë 13 Prill 2017, fshati Vrith, Njësia Administrative Shkrel, Shkodër.

Në trajnim me temë "Kërkimi marketing dhe mjetet e nevojshme për hulumtimin e tregut" morën pjesë 13 gra anëtare të grupit të zinxhirit të vlerës në zonën e Vrithit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit i grupit të zinxhirit të vlerës lidhur me rëndësinë e mbledhjes dhe trasmetimit të informacionit për të krijuar përfitim dhe vlerë superiore për produktin apo shërbimin si nga pikpamja konsumatore ashtu edhe e biznesit. Trajnimi u mundësua me mbështetjen e projektit SARED, bashkëfinancuar nga qeveritë e Danimarkës dhe Gjermanisë dhe që zbatohet në Shqipëri nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Nëpërmjet projektit SARED, GIZ mbështet me grantet dhe rritje kapacitetesh fermerë të zonave rurale me qëllim rritjen e prodhueshmërisë dhe cilësisë, si dhe lehtësimin e aksesit në tregje.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



MINISTRIA E BUIQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UETRAVE

Formatted: Centered

Formatted: Normal, Tab stops: 3,52 cm, Left

Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)

Gjatë diskutimeve aktive lidhur me mjetet e nevojshme, analizat dhe mënyrat korrekte e përdorimit të këtyre mjeteve për të arritur vlefshmerinë e tyre të plotë, dolën në pah vështirësitë e grupit të grave si: mungesë investimesh në kapacitete logjistike, akses i limituar në treg, promovim, etj, për të cilat kërkuan dhe mbështetjen suportin tonë. Gjithashtu gjatë kësaj teme trajnimi grupi i grave identifikoi vlerat e shtuara për produktet, si: rritje të cilësisë dhe ofertës së produkteve lokale, zgjerim të portofolit të produkteve, çmime më të larta për produktet finale, promovim i zonës dhe grupit të grave, etj.



14 Prill 2017 – Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Tamarës lidhur me: “Kërkimi marketing dhe mjetet e nevojshme për hulumtimin e tregut”.

Expert: PhD kandidate Iris Kazazi, Ekstensionist pranë Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër: z. Xheladin Zekaj, datë 14 Prill 2017, fshati Tamarë, Njësia Administrative Kelmend, Shkodër

17 gra të grupit të zinxhirit të vlerës në zonën e Tamarës morën pjesë në sesionin e trajnimit me temë “Kërkimi marketing dhe mjetet e nevojshme për hulumtimin e tregut”. Kjo temë u vlerësua si mjaft e rëndësishme nga grupi i grave në rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të tyre lidhur me rëndësinë e mbledhjes, përdorimit dhe menaxhimit efektiv të informacionit si një nga çështjet kryesore që sjell një vlerë të shtuar për produktet lokale dhe jetëgjatësi në treg. Njohuritë e marra gjatë trajnimit lidhur me mjetet e nevojshme dhe hapat e ndërmarra për të krijuar një vlerë superiore krahasuar me alternativat dhe stabilitet e qëndrueshmëri në treg, nxitën një debat aktiv lidhur me vështirësitë dhe nevojat e grave të tilla si: prezantim i dobët i produkteve lokale (paketim, etiketim), mungesë investimesh në teknologji dhe mjete për përmirësim e cilësisë së produkteve lokale, vështirësi në arritje dhe penetrim të tregjeve, promovim, etj. Gjithashtu, këto diskutime dhe njohuri të marra çuan në identifikimin e vlerave e shtuara për produktet e grupit të grave siç ishin: rritje të ofertës për produkte lokale cilësore, rritje të gamës së produkteve, rritje të çmimit për produktin final, promovim i zonës dhe grupit të grave.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



MINISTRIA E BUIQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TE UËRAVE

Formatted: Centered

Formatted: Normal, Tab stops: 3,52
cm, Left

Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)

Trajnimi u mundësua me mbështetjen e projektit SARED, bashkëfinancuar nga qeveritë e Danimarkës dhe Gjermanisë dhe që zbatohet në Shqipëri nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Nëpërmjet projektit SARED, GIZ mbështet me granted dhe rritje kapacitetesh fermerë të zonave rurale me qëllim rritjen e prodhueshmërisë dhe cilësisë, si dhe lehtësimin e aksesit në tregje.


